

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME SHKODËR SH.A

SEKTORI I BURIMEVE NJEREZORE

SHPALLJE PER VENDE TE LIRA PUNE

Bazuar ne Ligjin 7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punes i Republikes se Shqiperise” (i ndryshuar), mbështetur në Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërite Tregtare” të ndryshuar, Vendimit te Këshillit te Ministrave nr. 302, date 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për Riorganizimin e Sektorit te Furnizimit me Ujë të Largimit të Ujrave te Ndotura”, Statutit të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Qarku Shkodër sh.a. Vendimin Nr.11. datë 06.06.2024 “Për Miratimin e Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a”, Vendimit nr.9 date 18.12.2025, “Keshillit Mbikqyres”, Për miratimin e organigramës dhe nivelit te pagave për punonjësit e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Shkodër sh.a, shpallen procedurat e konkurimit per vend te lire pune:

2(dy) Hidraulik Shkoder

Detyrat dhe pergjegjesite kryesore

Hidrauliku varet nga Përgjegjësi Teknik dhe tekniku I sektorit.

Hidrauliku ka këto detyra:

1. Kryen ndërprerjen dhe rilidhjen e shërbimit të furnizimit me ujë sipas udhëzimeve të Inspektorit.
2. Instalon ujëmatësin sipas udhëzimeve të teknikut si dhe duke zbatuar me përpikmëri rregullat teknike të instalimit të matësit.
3. Kryen lidhjen e shërbimit nga rrjeti kryesor deri tek matësi i klientit duke zbatuar me përpikmëri rregullat teknik të lidhjeve të reja dhe projektin e pikës së lidhjes.
4. Paraqitet në punë me bazën materiale të furnizuar nga Përgjegjësi I tij dhe i pajisur me veshje dhe vegla pune.
5. Mbështet dhe merr pjesë aktivisht në kryerjen e inspektimeve nga Njësia Task Forcë e Drejtorisë Kujdesit ndaj Klientit duke u vënë në dispozicion të saj si dhe duke zbatuar udhëzimet e saj.
6. Njofton Përgjegjësin e Teknikun, për çdo problem që mund t'i lindë gjatë zbatimit të detyrës, dhe ndjek urdhrat dhe udhëzimet që i jepen prej tyre.
7. Të qëndrojë në vendin e punës dhe të mos largohet deri në kryerjen e detyrës së dhënë nga përgjegjësi apo tekniku i njësies

8. Është në gatishmëri edhe pas kohës së punës dhe paraqitet në punë kur i kërkohet nga eprori për çdo rast emergjence.
9. Të njohe mirë rregullat e sigurimit Teknik.

Kandidatet duhet të plotesojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- ✓ Te jene shtetas shqiptare .
- ✓ Arsim I ulet ose I mesem.
- ✓ Te jene ne gjendje te mire shendetesore dhe te afte fizikisht.

DOKUMENTACIONI , MENYRA DHE AFATET E DOREZIMIT

1. CV
2. Fotokopje ID
3. Librezë Pune
4. Certifikatë personale
5. Certifikatë e gjendjes familjare
6. Diplome shkolle (e noterizuar)
7. Listë notash (e noterizuar)
8. Certifikatë/ Dokument për kualifikime të ndryshme/Specializime
9. Dëshmi Penaliteti
10. Vertetim i Gjendjes Gjyqësore
11. Vertetim prokurorie
12. Saktësim adrese nga Bashkia
13. Raport Mjekoligjor (Aftësi në punë)
14. Foto të vogla (2 copë), foto e madhe (1 copë)

Afati i aplikimit 5 dite.

Kandidatet do të vleresohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve , Drejtoria e Burimeve Njerezore do të shpallë fituesit në portalin “ Sherbimi Kombëtar I Punësimit”, në faqen e internetit.

Kandidatet jo fitues kanë të drejtë të ankimohen pranë Drejtorisë së Burimeve Njerezore . Afati i Ankimit është 3 (tre) ditë nga data e shpalljes së fituesit.

